
Si të mbrohemi?

Vaksina kundër fruthit jepet si vaksinë MMR – kundër fruthit, shytave dhe rubeolës.

VAKSINIMI ËSHTË MBROJTJA MË E MIRË!

– Për mbrojtje të plotë nevojiten dy doza.
– Vaksinimi ul rrezikun e sëmundjes dhe komplikimeve të rënda.
– Përmes vaksinimit mbrojmë veten dhe ata që nuk mund të vaksinohen.

Kontrolloni nëse fëmija juaj i ka marrë të dyja dozat e vaksinës MMR.





Sigurohuni që fëmija juaj të jetë plotësisht i vaksinuar:

- Kontrolloni kartelën e vaksinimit / librezën shëndetësore ose kërkoni ndihmë nga mjeku juaj amë!
- Nëse fëmija juaj nuk është vaksinuar në kohë, sipas moshës, dërgojeni MENJËHERË në Shërbimin e Vaksinimit për t'u vaksinuar!

MËNYRA MË E MIRË PËR TA MBROJTUR FËMIJËN TUAJ NGA FRUTHI ËSHTË VAKSINIMI KUNDËR KËSAJ SËMUNDJEJE, SEPSE VAKSINIMI ËSHTË E VETMJA MASË PARANDALUESE E SUKSESSHME!

FRUTHI – MBROHUNI ME KOHË

Институт за јавно здравје



INFORMACIONE PËR POPULLATËN

Çfarë është fruthi?

Fruthi (morbili) është një nga sëmundjet virale më ngjitëse, i shkaktuar nga virusi Morbilli.

Cilat janë simptomat?

- Temperaturë mbi 39°C
- Dhimbje koke
- Plogështi
- Dhimbje dhe gërvishtje në fyt
- Kollë e thatë, rrjedhje nga hunda
- Sy të skuqur, të ënjtur dhe me lotim
- Skuqje karakteristike në lëkurë dhe mukozë


– Në lëkurë, zakonisht fillon në fytyrë dhe përhapet gradualisht në trup.
– Në mukozën e gojës dhe në qiellzën e butë shfaqen njolla të vogla si kokrra grizi.






Si transmetohet sëmundja?

Virusi transmetohet përmes ajrit, me pikëza të vogla sekrecionesh që personat e sëmurë i lëshojnë kur kolliten, teshtijnë ose flasin.



Personi i sëmurë mund ta transmetojë virusin 4 ditë para dhe 4 ditë pas shfaqjes së skuqjes. Virusi përhapet lehtë dhe shpejt nga njeriu te njeriu. Mbi 90% e personave në kontakt me të sëmurin mund të infektohen nëse nuk janë vaksinuar ose nuk e kanë kaluar sëmundjen.



Virusi mbijeton deri në 2 orë në mjedisin e jashtëm. Kjo mundëson transmetim indirekt përmes sendeve të kontaminuara së fundmi, lodrave të fëmijëve, sipërfaqeve të punës etj.

Komplikimet e mundshme:

Komplikimet më të shpeshta janë:
– Inflamacioni i veshit të mesëm
– Inflamacioni i rrugëve të frymëmarrjes dhe mushkërive
– Verbëria
– Inflamacioni i trurit dhe cipave të tij
– Vdekja nga komplikimet e rënda
Komplikimet janë më të shpeshta te fëmijët nën 5 vjeç dhe të rriturit mbi 20 vjeç.



Si trajtohen të sëmurët?

Nuk ka terapi specifike për fruthin. Trajtimi është simptomatik. Personat që e kanë kaluar fruthin fitojnë imunitet që zgjat gjatë gjithë jetës.